# DËSHMI ARKIVI

**A-476914**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Fitorja ndaj Bjellorusisë ngre moralin e Kombëtares” - Gazetari zbulon dy zgjedhjet e goditura nga Maran |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/sport/fitorja-ndaj-bjellorusise-ngre-moralin-e-kombetares-gazetari-zbulon-dy-zgj-i589002` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 16:01:25 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 16:00:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `80b383276a1072a18199b967f3d936b86aa407b2bf89981f69b65af9af689450` |
| TEKSTI | `831ddb39ee05ecf4517aaa8a9083e492880ea9df878ed722d0a7a98201566669` |
| PAMJA | `e4453b3749e3823f261d0d5b9ef71388742ee311120e8df6884791e04730c625` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `8f8c55abf5c26ba23337cd3f05558a66d251139abc761110254afbf511264737` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `2a9c3c61cd0a94fc8d628189ad3d77be9fe8dbec0733dde85be2277fcecb101e` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/8f8c55abf5c26ba23337cd3f05558a66d251139abc761110254afbf511264737`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# “Fitorja ndaj Bjellorusisë ngre moralin e Kombëtares” - Gazetari zbulon dy zgjedhjet e goditura nga Maran

TemA
28 Shtator 2026, 18:00Sport TEMA




Gazetari sportiv Fatjon Baze, i ftuar në emisionin “Mega Sport”, që transmetohet në A2 CNN dhe moderohet nga gazetari i njohur Altin Sulçe, komentoi fitoren e Shqipërisë ndaj Bjellorusisë.

Sipas tij, ky triumf ka një vlerë të veçantë për të ngritur moralin e ekipit kombëtar, i cili po kalonte një periudhë jo pozitive pas një serie rezultatesh negative.

“Fitorja vlen shumë për të ngritur moralin e futbollistëve, për arsye se që prej zyrtarizimit të trajnerit Maran, besueshmëria dhe pëlqyeshmëria ndaj tij kanë qenë mjaft të ulëta. Kjo situatë u rëndua edhe më shumë pas disfatave të rënda në miqësoret e verës. Por, për fat të mirë, sfida me Bjellorusinë shkoi mirë dhe morëm një tri pikësh të artë, edhe pse kundërshtari ishte mjaft i dobët”, u shpreh Fatjon Baze.

Ai shtoi se në këtë takim Shqipëria fitoi edhe një lojtar mjaft të mirë në krahun e majtë të mbrojtjes, Stavri Pilo.

“Nga formacioni i trajnerit më pëlqeu fakti që u besoi lojtarëve që kanë më shumë minuta aktivizimi në ekipet e tyre. Befasia ishte performanca mbresëlënëse e mbrojtësit Stavri Pilo në krahun e majtë, duke e bërë këtë pozicion të blinduar, duke pasur parasysh edhe konkurrencën me Mario Mitajn. Përveç fitores, fituam edhe një lojtar mjaft të mirë në prapavijë.

Gjithashtu, aktivizimi i Muçit ishte një zgjedhje perfekte, pasi është lojtari më në formë që kemi. Mjaftoi një rast dhe ai e shfrytëzoi në maksimum, duke shënuar me shumë klas. Mendoj se ai duhet të jetë pika jonë e referimit në repartin ofensiv”, përfundoi Fatjon Baze.

**https://www.youtube.com/live/-uhALgh9nxE?si=pg-ejG_F8S1mAN-_**

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[FIFA nis auditin ndaj FSHF-së, pas përplasjes së Dukës me Infantinon]

16:10 Sport

[UEFA Nations League - Kombëtarja mbyll përgatitjet në “Shtëpinë e Futbollit” për ndeshjen ndaj San Marinos]

14:10 Sport

[Gjermania, Schweinsteiger nuk i kursen kritikat: Kemi rënë në mediokritet. Klopp? Nuk është magjistar]

12:50 Sport / 4 komente

[Italia dhe frika për rënien në Ligën B, sa pikë duhen për ta evituar?]

11:20 Sport

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.